



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOKOL SH. MALAJ
ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI
TEL: 684055554



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1593

Nr. koleksioni: 715

Tirane më 12/07/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti notarial përbëhet nga 3 fletë



A2023050710077958098



A2023050710077958098

KONTRATË SHITJE KUOTË KAPITALI**ME KUSHT****(TË SHOQËRISË "KURTI SECURITY" SH.P.K)**

Sot, më datë 12 Korrik 2023 (dy mijë e njëzet e tre), ditën e mërkurë, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqitën personalisht:

PALA SHITESE:

Z. FRESKID PREKA i biri Alfons, dhe Mri, shtetas Shqiptar, lindur në Velipojë, Shkodër dhe banues në SHKODËR, me adresë MARK KOLA 03500046; Nd. 28; H. 2; ; VELIPOJË; BAKS I RI; 4020; SHKODËR, lindur më 09/08/1989, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032771010 dhe nr. personal I90809094U.

PALA BLERESE:

Z. ILIR JAHO, i biri i Leonard, dhe Valbona, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në VLORË, me adresë Cameria 04140066; Nd. 2; H. 11; Ap. 14; Vlorë; Vlorë; 9405; Vlorë, lindur më 21/04/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036172766 dhe nr. personal I50421107I.—

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noteri konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noteri redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "KURTI SECURITY" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

NENI 1**PËRSHKRIMI I OBJEKTIT**

Shitësi **Z. FRESKID PREKA** është ortak i Shoqërisë "KURTI SECURITY" shpk në kuotën konkretisht:

- **Z. FRESKID PREKA** zotëron 100% të kuotës së kapitalit.—

Shoqëria "KURTI SECURITY" Sh.p.k është Regjistruar si person juridik pranë QKB më datë 11.06.2013 me Nr unik të identifikimit të subjektit NIPT- **L38011902R**, e cila ndodhet me seli në Dibër Burrel, Lagjia Partizani, Rr. "Kuvendi i Dukagjinit", Ndërtesa Nr.77, Kati 1, dhe me Administrator **Z. FRESKID PREKA**.—



A202305071007795804

Pala shitëse/ Ortaku **Z. FRESKID PREKA** me vullnetin e sa të lirë e të plotë i shprehur në **Vendimin Nr—2**, të datës 12.07.2023 të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë “**KURTI SECURITY**” shpk, vendosur —shitjen me Akt Noterial të kuotës së tij prej 100% të kapitalit (pra, të shoqërisë, kapitalit, aseteve, të drejtave dhe detyrimeve që ka kjo shoqëri) — në favor të **Z. ILIR JAHO**.—

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

Në bazë të marrëveshjes së arritur mes palëve jashtë kësaj zyre, shitësi **Z. FRESKID PREKA** deklaron se është dakord që kuoten e tij prej 100% të kapitalit (pra, të shoqërisë, kapitalit, aseteve, të drejtave dhe detyrimeve që ka kjo shoqëri) që ai zotëron në shoqërinë “**KURTI SECURITY**” shpk, t’ia shesë blerësit **Z. ILIR JAHO** në vlerën **100.000 Lekë (njëqind mijë lekë)**.—

Pala shitëse deklaron se është plotësisht dakord që shoqëria të kalojë në emër dhe pronësi të blerësit **Z. ILIR JAHO**.—

Likujdimi i çmimit është bërë ndaj palës shitëse **Z.FRESKID PREKA** me para në dorë (CASH) përpara nënshkrimit të këtij Akti noterial.—

Edhe Blerësi **Z. ILIR JAHO** deklaron se pranon të blejë këtë kuotë të kapitalit në shoqërinë e mësipërme në çmimin që ata kanë caktuar në marrëveshje të përbashkët, shumë kjo e cila është likujduar me para në dorë (CASH) përpara nënshkrimit të këtij akti noterial.—

Veç sa më sipër, Blerësi deklaron se është dakord që të blejë këtë shoqëri me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ajo ka. Blerësi deklaron se është në dijeni të plotë të gjendjes aktuale financiare të kësaj shoqërie, se ka kontrolluar librat e kontabilitetit dhe se nuk ka asnjë pretendim apo mosmarrëveshje.—

Pra, me hartimin dhe nënshkrimin e këtij Akti Noterial, shitësi **Z.FRESKID PREKA** e humbet të drejtën e pronësisë në këtë shoqëri dhe Ortak i vetëm i ligjshëm i kësaj Shoqërie, në kuotën 100%, dhe Administrator bëhet blerësi **Z. ILIR JAHO**.—


Pala shitëse është plotësisht dakord që kjo shoqëri të kalojë në emër të palës blerëse **Z. ILIR JAHO**.

Blerësi është i detyruar të paraqesë pranë **Q. K. B.** Vendimin e Ortakut të vetëm dhe aktin noterial të shitjes së kuotave në favor të ortakut të vetëm **Z. ILIR JAHO**.—

NENI 3

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.



NENI 4

ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakut të Vetëm me nr. 2, datë 12.07.2023, bashkëlidhur vërtetim nënshkrimi.
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "KURTI SECURITY" Sh.p.k. datë 11.07.2023;
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

NENI 5

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITESE:

Z. FRESKID PREKA

Freshid Preka

PALA BLERESE:

Z. ILIR JAHO

ILIR JAHO

NOTER

SOKOL SH. MALAJ

NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR "LUIGJ GURAKUQI" P 2 TIRANË, ALBANIA
Tel. +355 4 222 98 32 / Cel. +355 68 40 5555 4
e-mail: kollomalaj@hotmail.de

**TAKSA E PULLES
U PAGUA**